

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik “INTERLOGISTIC” sh.p.k me adrese Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe, me NIPT K21605003M.**

Procedura e prokurimit: **e hapur- mallra (me mjete elektronike) mbi kufirin e larte monetar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-26060-04-21-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: objekti “Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a, per nje vit”, me vlere limit të përlogaritur të kontratës 59,423,158 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e tete) leke, pa TVSH ose 494,369 (katerqind e nentedhjetë e kater mije e treqind e gjashtedhjetë e nente) Euro pa tvsh dhe me kohezgjatje te kontrates 12 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme: **Nr. 26 datë 28 Shkurt 2022**

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 53 datë 26 Prill 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim -X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Infosoft Office” shpk me Numer NIPT J62426002Q.

Vlera 47,374,239.64 (dyzet e shtate milion e treqind e shtatedhjetë e kater mije e dyqind e tridhjetë e nente pike gjashtedhjetë e kater) leke pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “Librari Dyrrahu” shpk me Numer NIPT L91418502J

Vlera 47,747,725 (dyzet e shtate milion e shtateqind e dyzet e shtate mije e shtateqind njezet e pese) leke pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “Marketing &Distribution” shpk me Numer NIPT J 72124001N

Vlera 57,454,392 (pesedhjetë e shtate milion e katerqind e pesedhjetë e kater mije e treqind nentedhjetë e dy) leke pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik “INTERLOGISTIC” shpk me Numer NIPT-it K21605003M

Vlera 59,032,679.90 (pesedhjetë e nente milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e nente pike nentedhjetë) leke pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- OE **“Librari Dyrrahu” shpk** nepermjet shkreses date 25.05.2022, ben me dije se ka shlyer te gjitha detyrimet tatimore, verifikuar kjo me shkresen e tatimeve nr.4472/1 date 25.05.2022 te Drejtorise Rajonale Tatimore Durres, por nuk sjell ansje prove apo argument se pse ne daten dhe oren e hapjes rezulton me detyrime tatimore, kjo referuar vertetimit te aksesuar ne elabania nga KVO. Ne keto kushte KVO vlereson se ky operator nuk permbushe kerkesen e parashikuar ne piken 1/dh te KPK shtojca 7- *“nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.* Gjithashtu KVO gjate vleresimit te dokumentacionit te ofertes te doresuar ne SPE, konstaton se operatori ekonomik **“Librari Dyrrahu” shpk**, nuk ploteson piken 2.2.2 te kapaciteteve ekonomike dhe financiare pasi bilanci i vitit 2019 nuk eshte dorezuar i shoqeruar me akt ekspertizen e eksperti kontabel te autorizuar. Ne keto kushte vendosi te refuzoj oferten si të papërgjegjshme.
- OE **“Marketing & Distribution” shpk** nepermjet shkreses date 26.05.2022 protokolluar prane nesh me nr.5153 prot date 26.05.2022, ben me dije se detyrimi vjen si pasoje e mases administrative gjobe marre nga punonjesve te saj e cila eshte shfaqur ne sistem ne date 11.05.2022 dhe thekson qe me marrjen e kerkeses per sqarim nga ana jone ka marr masa per te likujduar plotesisht detyrimin ne date 24.05.2022 nje dite pas hapjes se ofertave. Pra ky operator nuk sjell ansje prove apo argument qe ne daten e hapjes se ofertave ploteson kerkesen e pikes 1/dh te KPK shtojca 7. Ndaj ne keto kushte KVO vlereson se ky operator nuk permbushe kerkesen e parashikuar ne piken 1/dh te KPK shtojca 7- *“nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.* KVO vendosi te refuzoj oferten si të papërgjegjshme.
- Ne date 16.09.2022 Njesia e Prokurimit ka rikthuer per rivleresim procedure dhe Komisioni i Vleresimit te Ofertave realizoi procedurat ne SPE dhe refuzoi oferten e paraqitur nga operatori ekonomik **“Infosoft Office” sh.p.k** sipas gjetjeve te KPP te pasqyruara ne vendimin nr. 887/2022 datë 14.09.2022.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorit Ekonomik “INTERLOGISTIC” shpk** me adrese **Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe, me NIPT K21605003M** se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **59,032,679.90 (pesedhjetë e nente milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e nente pike nentedhjetë) leke pa TVSH / totali i pikëve të marra 100 është** identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [OSHEE Group sh.a, ne adresen Bulevardi **“Gjergj Fishta”**, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Njësise se Prokurimit]

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, *ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të rregulluar nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.*

Ankesat: me Nr. 6022 prot, datë 17.06.2022 nga shoqëria “ **INTERLOGISTIC** ” sh.p.k.

Vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës nr.887/2022 date 14.09.2022 ne te cilin KPP ka vendosur:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit 13 59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ne date 16.09.2022 është rivlerësuar procedura dhe ne zbatim të gjetjeve të vendimit të KPP nr. 887/2022 datë 14.09.2022 është skualifikuar operatori ekonomik “**Infosoft Office**” sh.p.k.

Me shkresën nr. 8659/1 prot., date 21.09.2022 është njoftuar KPP për zbatimin e vendimit nr. 887/2022 datë 14.09.2022,

Me vendimin NR.940/2022 date 28.09.2022 të KPP-se është vendosur:

- *Te lejoje autoritetin për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*